

## **Akt Themelimi**

I shoqerise tregtare "FENIX 22" sh.p.k

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512

date 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit" , te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , " Per shoqerite tregetare" dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 "Per Q.K.R dhe formalitetet qe duhet respektuar nga Shoqerite Tregtare , me vullnetin e tij te lire , te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi nga ortaku z. Bujar Allushi banues ne Sarande, dhe nga ortaku z. Lorenc Zervoj banues ne Delvine, krijojne shoqerine tregtare me perjegjesi te kufizuar "FENIX 22" sh.p.k me akt themelimi si vijon :

## **Formulimi**

### **Neni 1**

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur "FENIX 22"sh.p.k . Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqipetar , ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega . Shoqeria do te ushtrje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues .

### **Selia e Shoqerise**

### **Neni 2**

Selia e shoqerise tregtare private "FENIX 22" sh.p.k do te kete seline: Lagjja nr.2, Rr. Gjergj Araniti, Pallati nr. 40, Apartamenti 10, Sarande. . Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj , te hape zyra perfaqesie , dege , te krijoje filiale si Brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise , vetem me vendim te asamblese te ortakeve .

### **Objektivi i Veprimitarise**

### **Neni 3**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne fushen e :

- Veprimitari në fushën e ndërtimit, gërmime dheu me punime eventuale murature dhe beton arme, prishje dhe punime në tokë të gërmuar. Ndërtime civile - industriale - turistike, bujqësore deri në 5 kate, rikonstruksione. Ndërtim banesa me skelete mbi 8 kate. Ndërtim i rrugëve të kategorive të ndryshme II, III, IV, V, punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit në rrugë, ndërtim mbishtresa rugore. Ndërtim ura dhe vepra arti mbi 10 m, ndërtim ujësjellës, kanalizime, impiante vaditje, punime mbrojtje të sistemit hidraulik,

çimentime, etj. Sillosa, kulla uji prej beton arme, metalike, punime karpenterie druri.

- Tregtim automjete të çdo lloji, marke, tonazhi, si dhe pjesë këmbimi për to. Administrimi i vajrave të përdorur dhe të anijeve
- Import - eksport me shumicë dhe pakicë të mallrave të ndryshme industriale, bujqësore, blektorale, mjeksore.
- Administrim i mbetjeve urbane dhe inertesh.
- Shërbime hotelerie dhe agjensi turistike.
- Agjensi imobiliare. Konsulencë imobiliare, zyre ndermjetesimi per pasurite e paluajtshme, aktivitet ndermjetesimi per pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme.
- Agjensi per shitje biletash transporti udhetarësh me automjete tokësore, ajrore, ujore, etj.
- Import-eksport, tregeti me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem, industrial, ushqimor, te produkteve te ndryshme bujqësore, blegtoral e fruta perime, prodhimeve te detit, pije freskuese, te miellit e nenprodukteve te tij, te konfeksioneve e veshmbadhjeve, paisje elektroshtepiake, elektrike, elektronike, komjutera si dhe pjeset e tyre, higjenosanitare, hidraulike, prodhime qeramike, artizanati, duralumini, profileve etj te ketij lloji, te lendes drusore te perpunuar e paperpunuar, lekures e nenprodukteve te tyre, mobiljeve, lendeve te para te te gjitha llojeve, materiale dhe lendeve te ndertimit, pllakave te llojeve dhe dimensioneve te ndryshme materiale plastike, gome, e nenprodukteve te tyre.
- Tregetim me shumice dhe pakice te karburanteve, vajra e lubrifikante, acide, goma etj.

### **Kohezgjatja e Shoqerise**

#### **Neni 4**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat te pacaktuar . Ajo mund shperbehet ne cdo kohe dhe per cfardo lloj shkaku .

### **Kapitali i Shoqerise**

#### **Neni 5**

Kapitali fillestar i shoqerise private "FENIX 22" sh.p.k do te jete 100.000 (njeqindmije leke ).

Kapitali eshte i ndare ne 2 kuota te ndara keto ne:

1 (nje) kuote ose 50% te aksioneve e zoteron ortaku z. Bujar Allushi dhe

1 (nje) ose 50% te aksioneve e zoteron ortaku z. Lorenc Zervoj

Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet ( por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar ).

## **Drejtimi i Shoqerise**

### **Neni 6**

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj , z. Lorenc Zervoj.  
Ai eshte perfaquesuesi i Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetencia te plota ne drejtimin e saj .  
Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaquesues i pajisur me prokure te posacme .

### **Neni 7**

Ortaket themelues kane te drejte te emeroje dhe administratore te tjere te vlerave materiale  
Kane te drejte te caktoje financiere , likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortake .

### **Neni 9**

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqipetar.

### **Neni 10**

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme , me tekstin rreth saj .

### **Neni 11**

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plotë te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqipetar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare" , si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri .

### **Neni 12**

Akti i themelimit u perpilua ne 2 kopje , per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "FENIX 22" sh.p.k

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaket e shoqerise .

Ky akt-themelimi hartohet dhe nenshkruhet sot me dt. 02.02.2022.

**Ortaket themelues te "FENIX 22" sh.p.k**

Bujar Allushi  


Lorenc Zervoj  
